

Ligji Nr. 9150, datë 30.10.2003 “Për Urdhrin e Farmacistëve në Republikën e Shqipërisë” e përcakton Urdhrin si Ent Publik, i cili përbëhet nga individë, që ushtrojnë profesionin e farmacistit në Republikën e Shqipërisë dhe përfaqëson interesat e tyre profesionale në nivel partneriteti institucional.

Urdhri është person juridik i pavarur, krejtësisht profesional i shoqërisë civile. Ai është i depolitizuar dhe i departizuar, i hapur dhe i barabartë për të gjithë anëtarët, pavarësisht nga përkatësitë e tyre racore, fetare apo bindjet politike.

Është kategorikisht e ndaluar që gjatë veprimtarisë së tyre, në organet e strukturat e të gjitha niveleve të Urdhrit, të diskutohen apo reflektohen dukuri ose probleme të karakterit politik, partiak, racor, etnik e fetar.

Urdhri përbëhet nga farmacistë që ushtrojnë profesionin në Republikën e Shqipërisë dhe që përmbushin kriteret e përcaktuara nga Këshilli Kombëtar për të qënë anëtarë, sipas Ligjit Nr. 9150, datë 30.10.2003 “Për Urdhrin e Farmacistëve në Republikën e Shqipërisë”.

Anëtarë të Urdhrit bëhen individët, shtetas shqiptarë, të titulluar farmacistë në Republikën e Shqipërisë ose jashtë saj, që pranojnë Kodin Deontologjik Farmaceutik Shqiptar dhe që ushtrojnë këtë profesion në sektorin e prodhimit farmaceutik, të shërbimit dhe të shpërndarjes farmaceutike, ambulate e spitalore, publike e private, ose në sektorë të tjerë të shëndetësisë.

Përjashtohen nga ky detyrim, por jo nga e drejta e anëtarësimit në Urdhër, farmacistët funksionarë të administratës publike, për sa kohë që ata nuk ushtrojnë veprimtari të mirëfilltë profesionale farmaceutike.

Ndaj vendimit, që refuzon kërkesën për anëtarësim e regjistrim, kërkuesi ka të drejtë të ankohet pranë Këshillit Kombëtar jo më vonë se 30 ditë nga dita e shpalljes dhe marrjes së njoftimit për vendimin. Këshilli Kombëtar e shqyrton atë jo më vonë se 2 muaj nga paraqitja e ankesës. Ky vendim është i formës së prerë.

Kërkuesi ka të drejtë t’i drejtohet Këshillit Rajonal përsëri me kërkesë vetëm 6 muaj pas përgjigjes negative të Këshillit Kombëtar, vetëm nëse ka plotësuar kriteret e duhura për anëtarësim.

Ankesat mund të dreejtohen në rrugë postare në adresën:

Urdhri i Farmacistëve të Shqipërisë
Rruga Xhanfize Keko, Porcelan, Tiranë

Ose në adresën elektronike info@ufsh.org.al